



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1187 Prot.

Tiranë, më datë 05.10.2022

VENDIM  
Nr. 485, datë 05.10.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 05.10.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Gjergj Vinjahu, në kuadër të projektit “Nënstacioni Ngritës Starje dhe Linja Elektrike “Erseka Solar Park 1 dhe Erseka Solar Park 2”, me aplikues Gjergji Vinjahu dhe zhvillues Favina Sh.p.k, Favina 1 Sh.p.k, M&K Energy Trading Sh.p.k;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryejën e punimeve për projektin “Nënstacioni Ngritës Starje dhe Linja Elektrike “Erseka Solar Park 1 dhe Erseka Solar Park 2”, si dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e me pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Rudina ZOTO



KRYETAR

Elyza MARGARITI